



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL**

Bulevardi "Zog I", Godina 57/2, Tiranë

Tel. 04 268142; Fax 04268141

Nr. 115/5 Prot.

Tiranë, më 18.03. 2016

**V E N D I M**

**Nr. 25, datë 18.03.2016**

**Mbi përfundimin e hetimit administrativ,  
filluar me Urdhrin e verifikimit nr. 115/1 prot., datë 16.02.2016**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, neneve 80-104 të ligjit nr. 8485, datë 12.05.1999, "Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë", si dhe nenit 35, të Rregullores "Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit", miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të relacionit nr.57 prot., datë 09.03.2016 dhe mendimit të Drejtorisë së Inspektimit dhe Hetimit Administrativ, në lidhje me disa parregullsi të konstatuara në ecurinë e marrëdhënies së punësimit, të punonjësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, \*\*\*\*\*.

**VËREJ:**

Në zbatim të urdhrin nr. 115/1 prot., datë 16.02.2016, "Për verifikimin e informacionit të ardhur në lidhje me emërimin nëpërmjet procedurës së konkurrimit të nëpunësit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, \*\*\*\*\*", ka filluar hetimi administrativ, dhe mbas këqyrjes në institucion të akteve që materializojnë procedurën e ndjekur për emërimin e nëpunësit nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, si dhe akteve të ardhura nga Departamenti i Administratës Publike me shkresën nr. 761/1 prot., datë 22.02.2016, ka rezultuar se :

Me Vendimin nr. 72, datë 16.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, punonjësi \*\*\*\*\* është emëruar nëpunës civil në periudhë prove, në pozicionin "Përgjegjës i Sektorit të Projekteve TIK", në Drejtorinë e Teknologjive të Informacionit, pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve. Pas emërimit në këtë pozicion pune, përmes Vendimit nr. 303, datë 21.01.2014, të Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, ky punonjës, është komanduar në pozicionin "Drejtor i Drejtorisë së Teknologjive të Informacionit", akt i cili e ngarkon atë me

detyrat e këtij pozicioni, por që në mënyrë specifike përcakton se marrëdhëniet financiare do të vazhdojnë të jenë të lidhura me pozicionin e mëparshëm të punës, pra nuk do të ndryshojnë.

Me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, konstatohet se Departamenti i Administratës Publike, si njësi përgjegjëse e këtij institucioni, në zbatim të nenit 67, të këtij ligji, ka filluar procedurën për deklarimin e statusit të punësimit, për punonjësit e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.

Duke u nisur nga korrespondenca midis dy institucioneve rezulton se, me shkresën nr. 1603/6 prot, datë 30.10.2014, “Për statusin e punësimit të disa punonjësve”, Departamenti i Administratës Publike është shprehur se: “nuk mund të nxjerrë aktin e deklarimit të statusit të punësimit për punonjësin \*\*\*\*\*”, pasi dosja e tij personale mungon.”

Në vijim të kësaj procedure, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, me shkresën nr.8005/20, datë 08.04.2015, i ka vënë në dispozicion Departamentit të Administratës Publike, dosjen personale të punonjësit \*\*\*\*\* , ku mes të tjerash është dërguar:

- Diploma e nivelit “Bachelor”, e nëpunësit \*\*\*\*\* , lëshuar në datën 10.11.2011, nga Universiteti Politeknik i Tiranës, në degën “Inxhinieri Elektronike “, si edhe lista e notave;
- Diploma “Master i Shkencave”, e nëpunësit \*\*\*\*\* , lëshuar nga Universiteti “KRISTAL”, në degën “Inxhinieri e Teknologjive të Informacionit”, në datën 30.08.2014.

Pasi ka administruar dokumentacionin e mësipërm, Departamenti i Administratës Publike, me aktin nr. 1603/1092, datë 08.06.2015, ka formalizuar deklarimin e statusit të punësimit, për punonjësin \*\*\*\*\* , si “nëpunës civil në periudhë prove”, për pozicionin e punës “Përgjegjës i Sektorit të Projekteve TIK”, në Drejtorinë e Teknologjive të Informacionit, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve. Ky akt i është komunikuar Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, me shkresën nr. 1410, datë 08.06.2015.

Ndërkohë, rezulton se me shkresën nr. 13787 prot., datë 23.04.2015, të Zv/Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, në zbatim të nenit 24, të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, të ndryshuar, bazuar në rezultatin e testimit pranë Shkollës Shqiptare të Administratës Publike (ASPA), si dhe pas vlerësimit të rezultateve të punës, në përfundim të periudhës së provës, nëpunësi \*\*\*\*\* , është konfirmuar si nëpunës civil në pozicionin “Përgjegjës i Sektorit të Projekteve TIK”.

Nga analiza në tërësi e dokumentacionit dhe rrethanave të çështjes, Komisioneri konstaton një sërë parregullsish, të cilat kanë të bëjnë me aspekte të ndryshme të administrimit të shërbimit civil, që do të argumentohen në vijim të vendimit, ndër të cilat fillimi i marrëdhënies së punës me shërbimin civil dhe më tej, deklarimi i statusit të punësimit, për punonjësin \*\*\*\*\* ,

duke mos respektuar procedurat ligjore të kërkuara nga dispozitat që rregullojnë marrëdhëniet specifike të punës në shërbimin civil, për arsye të do të rendisim më poshtë.

Ligji për shërbimin civil, e vendos marrëdhënien e punës në sistemin e shërbimit civil, në disa korniza ligjore specifike, të cilat përbëhen nga rregulla të detyrueshme për t'u ndjekur nga të gjitha institucionet që punësojnë nëpunës civilë, gjatë aplikimit në praktikë të instituteve të ligjit, e që përcaktojnë në fakt edhe përmbajtjen e këtij ligji.

Ligji nr. 8549/1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", tashmë i shfuqizuar dhe ligji aktual, nr.152/2013, "*Për nëpunësin civil*", i ndryshuar, janë dy aktet ligjore, që kanë rregulluar sistemin e shërbimit civil, që nga momenti i krijimit të tij.

Respektimin e rregullave të vendosura në përmbajtjen e këtyre akteve ligjore, të përmendura më sipër, ndryshe nga rregullat e përgjithshme të marrëdhënies së punës, të vendosura nga Kodi i Punës, ligjvënësi e ka siguruar nëpërmjet përcaktimit të disa procedurave të veçanta, specifike, të vendosura parimisht në ligj dhe të specifikuar në aktet nënligjore që kanë dalë në bazë dhe për zbatim të tij, në të cilat përcaktohen rregullime të hollësishme dhe që kanë lidhje me të gjitha institutet e ligjit.

Këto procedura zbatohen duke filluar me momentin e fillimit të marrëdhënies së punës, nëpërmjet procedurës së konkurrimit, e cila në vetvete përbëhet nga faza të ndryshme procedurale në të cilat zhvillohet ky proces, për të siguruar zbatimin e parimeve të rekrutimit në shërbimin civil, të tilla si transparenca, merita dhe mos diskriminimi; duke vazhduar me zgjatjen e marrëdhënies së punës pa një afat të përcaktuar (*e përhershme dhe jo kontraktuale*), e më tej, me zhvillimin e sistemit të karrierës, nëpërmjet zbatimit të procedurës së lëvizjes paralele e ngritjes në detyrë; sistemin disiplinor, nëpërmjet zhvillimit të procedurave të caktuara të ecurisë disiplinore; e kështu me radhë.

Në rastin konkret, duke u nisur nga dispozitat e parashikuara në nenet 19 dhe 20, të ligjit nr.9920, datë 19.05.2008, "*Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë*", i ndryshuar, i cili është një ligj i posaçëm që rregullon veprimtarinë e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, rezulton se në të është parashikuar në mënyrë të qartë se për punonjësit që janë në pozicione pune pjesë e shërbimit civil, të zbatohet legjislacioni i nëpunësit civil, që zbatohet në rastin e institucioneve të pavarura.

Në këto rrethana, sipas nenit 10 të ligjit të kohës, nr. 8549/1999 "*Statusi i nëpunësit civil*", i kombinuar edhe me dispozitat e përmendura më sipër, organi kompetent për zhvillimin e procedurave të rekrutimit, lëvizjes paralele dhe ngritjes në detyrë, është Departamenti i Personelit të këtij institucioni.

Në vijim të kësaj analize, në mbështetje të dispozitave të përgjithshme të ligjit të kohës që rregullonte procesin e rekrutimit në shërbimin civil; të ligjit të posaçëm që rregullon

veprimtarinë e institucionit; si dhe në zbatim të një akti nënligjor, i cili për shkak të natyrës specifike të punës së institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve, ka qenë specifik, pasi e rregullonte ndryshe këtë proces, nga pjesa tjetër e shërbimit civil, (*bëhet fjalë për Vendimin nr. 1184, datë 20.08.2008, të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e administratës tatimore Qendrore”, i ndryshuar, aneksin nr.1*) Departamenti i Personelit të institucionit, ngarkohej për të kryer procedurën e rekrutimit, duke filluar procesin me fazën e shpalljes së një pozicioni të lirë dhe publikimin e kriterëve të përgjithshme dhe të posaçme që duhet të përmbushnin kandidatët për të marrë pjesë në konkurrimin për këtë pozicion pune.

Këto detyrime rrjedhin prej përcaktimeve të akteve ligjore, nënligjore dhe akteve administrative që kanë dalë në zbatim të tyre, si më poshtë:

- Ligjit nr. 8549, dt. 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, në fuqi në momentin e kryerjes se procedurës së rekrutimit.
- Vendimi nr. 1184, datë 20.08.2008, i Këshillit të Ministrave “*Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e administratës tatimore Qendrore*”, i ndryshuar, aneksi nr.1;
- Vendimit nr. 545, dt. 11.8.2011 i Këshillit të Ministrave “*Për Miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve civilë/nëpunësve, Zëvendësministrit dhe nëpunësve të Kabineteve, në Kryeministri, Aparatet e Ministrive të Linjës, Administratën e Presidentit, Kuvendit, Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, Prokurorinë e Përgjithshme, Gjykatën e Lartë, disa Institucione të Pavarura, Institucionet në varësi të Kryeministrit, Institucionet në Varësi të Ministrave të linjës dhe Administratën e Prefektit*”, i ndryshuar me Vendim nr. 589, Datë 17.7.2013 “*Për disa ndryshime në Vendimin nr. 545, datë 11.8.2011*”, Lidhja nr. 6/9 “*Struktura dhe nivelet e pagave për punonjësit e sistemit të tatimeve*”
- Rregullores së Brendshme të institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve.
- Formularit të përshkrimit të punës, për pozicionin “*Përgjegjës i Sektorit të Projekteve (TIK)*”, pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit.

Aktet e përmendura më sipër, referojnë procedura të posaçme, specifike të cilat duhet të respektohen nga njësia e administrimit të burimeve njerëzore në këtë rast, duke filluar me momentin e verifikimit, nëse konkurrentët që kanë aplikuar për të marrë pjesë në konkurrim, për pozicionin e punës, “*Përgjegjës i Sektorit të Projekteve (TIK)*”, pranë Drejtorisë së Teknologjisë së Informacionit, i plotësojnë, ose jo, kërkesat e përgjithshme dhe të posaçme të cilat janë të materializuara në formularin e përshkrimit të punës.

Në rastin që po analizojmë, duke u nisur nga përshkrimi i punës i cili na është vënë në dispozicion nga institucioni, rezulton se kandidatët konkurrentë, për këtë pozicion pune duhet të plotësonin kriterin arsimor, në nivelin Diplomë e Nivelit të Dytë ose Diplomë e Integruar e

Nivelit të Dytë, në një prej degëve të shkencave elektronike, si në informatikë, elektronikë, ose në degë të ngjashme me to.

Po kështu, një kërkesë tjetër specifike ishte edhe kriteri i vjetërsisë në punë, ku kandidatët kërkoheshin me një përvojë pune në këtë fushë, mbi 3 vjet, duke e përcaktuar edhe në nivelin ekzekutiv të shërbimit civil.

Duke pasur parasysh këto kërkesa, Komisioneri i ka krahasuar ato, me atë ç'ka është publikuar prej institucionit dhe rezulton se, sipas njoftimit të realizuar përmes faqes "online", të gazetës "Monitor", të datës 01.11.2013 (<http://www.monitor.al/tatimet-hapin-konkurs-per-150-vende-pune/>), në ndryshim nga kërkesat e përcaktuara në dokumentin e përshkrimit të punës, njësia e burimeve njerëzore, si kërkesa të veçanta që duhet të plotësonin kandidatët ka përcaktuar:

*"Të ketë arsimin e lartë në degën informatike, ose elektronike \*(diplomë DND ose DIND) brenda ose jashtë vendit" dhe eksperiencë pune (pra nuk është përcaktuar në kohë vjetërsia në punë, ashtu si është materializuar në përshkrimin e punës, 3 vjet).*

Pra, ashtu si rezulton nga ajo ç'ka është paraqitur më sipër, në këtë rast konstatohet se pa asnjë argument ligjor, në shpalljen e pozicionit të lirë, nga ana e njësisë së personelit, nuk është publikuar kërkesa për një periudhë 3 vjeçare, të përvojës në punë të kandidatëve.

Për të verifikuar faktin, nëse konkurenti në fjalë, në momentin e konkurrimit, e plotësonte ose jo, realisht kërkesën për vjetërsisë në punë (3 vjet), u administruan aktet që pasqyrojnë kohën e diplomimit të punonjësit në fjalë, (i cili është shpallur edhe kandidat fitues në konkurrim) dhe rezultoi se, diploma e nivelit të parë të studimeve të larta "Bachelor", është lëshuar nga institucioni i edukimit arsimor, në datën 10.11.2011, që do të thotë se kriteri i vjetërsisë në punë, nuk plotësohej prej tij.

Në këto rrethana, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Departamentit të Personelit të institucionit, si mekanizmi i ngarkuar për të kryer procedurat e verifikimit në këtë fazë të konkurrimit, nuk janë respektuar kërkesat e përcaktuara në formularin e përshkrimit të punës, si dhe në Aneksin 1, të Vendimit nr. 1184, datë 20.08.2008, të Këshillit të Ministrave "Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e Administratës Tatimore Qendrore", i ndryshuar, ç'ka e bën të pavlefshëm të gjithë procesin.

Nga ana tjetër, në vijim të hetimit administrativ, në lidhje me zbatimin e procedurave gjatë rekrutimit të punonjësit në fjalë, rezulton se, në momentin e kryerjes së konkurrimit, ai nuk plotësonte edhe kriterin arsimor, pasi duke u nisur nga niveli i pozicionit të punës për të cilin është zhvilluar konkurrimi, në hierarkinë administrative të pozicioneve të punës në shërbimin civil, pozicioni "Përgjegjës Sektori", kërkon studime të thelluara në fushën përkatëse, të cilat kërkojnë patjetër diplomimin në nivelin DND, ose DIND, ndërkohë që ky punonjës, në

momentin e konkurrimit zotëronte vetëm diplomën në nivelin “*Bachelor*”, në degën “*Inxhinieri Elektronike*”, pasi diploma e nivelit “*Master i Shkencave*”, është lëshuar nga Universiteti “*KRISTAL*”, në degën “*Inxhinieri e Teknologjive të Informacionit*”, në datën 30.08.2014.

Faktet e përshkruara më sipër, provojnë se punonjësi \*\*\*\*\*, në momentin e kryerjes së konkurrimit, nuk plotësonte dy kritere të rëndësishme që kërkoheshin për pozicionin e punës dhe konkretisht kriterin arsimor dhe kriterin e vjetërsisë në punë, të cilin në momentin e shpalljes, njësia përgjegjëse e ka hequr në mënyrë të paarsyetuar dhe të pajustificuar, duke e mënjanuar pa të drejtë, si kriter seleksionues.

Kapërcimet e lejuara nga Departamenti i Personelit të këtij institucioni, gjatë procedurës ligjore të përcaktuar për verifikimin e përmbushjes së kritereve ligjore prej konkurrentëve, ka sjellë si pasojë pranimin, e më tej, fitoren e kandidatit në konkurrim, pa të drejtë.

Këto arsye, e bëjnë gjithë procedurën e pranimin dhe për pasojë edhe aktin e emërimit në përfundim të saj, të kryer në kundërshtim flagrant me ligjin, për faktin se nuk janë respektuar kërkesat e nenit 12, pika “c”, të ligjit nr. 8549 dt. 11.11.1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, që ishte efektiv në kohën e kryerjes së konkurrimit, si dhe nuk janë zbatuar procedurat e pranimin në shërbimin civil, që kanë të bëjnë me fazat e rekrutimit, të përcaktuara në nenin 13, pika 5, e këtij ligji, ku parashikohet shprehimisht se :

*“Konkurrimi zhvillohet në tri faza: a) Në fazën e parë bëhet përzgjedhja e kandidatëve për t’iu nënshtruar testimit dhe konsiston në verifikimin, nëse kandidatët plotësojnë kërkesat e përgjithshme dhe të veçanta të përcaktuara në shpalljen për konkurrim. Vetëm kandidatët që plotësojnë këto kërkesa, do të pranohen për t’iu nënshtruar fazës së testimit. Kjo fazë zhvillohet nga Departamenti i Administratës Publike për institucionet e administratës qendrore dhe nga departamentet e personelit për institucionet e pavarura. ....”*

Këto dispozita të përmendura më sipër, kërkojnë që, kandidatët që pretendonin për një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, të përmbushnin kërkesat ligjore për nivelin arsimor dhe të zotërojnë aftësitë e nevojshme profesionale për vendin përkatës të punës. Duke zbrërthyer përmbajtjen e kësaj dispozite dhe duke e krahasuar me rrethanat e rastin konkret, rezulton se konkurrenti \*\*\*\*\*, nuk përmbushte as kriterin arsimor të kërkuar dhe as kriterin e aftësisë profesionale për vendin e punës, i cili është ekuivalent me vjetërsinë e kërkuar në përshkrimin e punës.

Mungesa e këtyre elementeve të rëndësishëm, e bën të pavlefshme edhe të gjithë procedurën e rekrutimit në këtë rast, e pikërisht në fazën e parë të këtij procesi, të parashikuar nga neni 13, pika 5 e ligjit nr. 8549/1999 “*Statusi i nëpunësit civil*”, dispozitë të cilën e kemi cituar më sipër dhe që parashikon verifikimin e plotësimin të kritereve të përgjithshme dhe të posaçme, për kandidatët në konkurrim, detyrë me të cilën është ngarkuar Departamenti i Personelit në këtë rast.

Në këtë këndvështrim, në kuptim të nenit 115 e vijues të Kodit të Procedurave Administrative, Komisioneri vlerëson se ndodhemi në kushtet e pavlefshmërisë absolute, në lidhje me të gjitha aktet administrative që materializojnë procedurën, në të gjitha fazat e konkurrimit (3 faza), duke përfshirë edhe aktin e emërimit të këtij punonjësi si nëpunës civil, pas konkurrimit.

Në këtë aspekt, punonjësi nuk mund të trajtohet sipas përcaktimeve të pikës 3, të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013, "Për nëpunësin civil", të ndryshuar, në kategorinë e nëpunësit civil ekzistues.

Po kështu, edhe nëse do ta konsiderojmë këtë punonjës, në kategorinë e punonjësve ekzistues, të cilët ligji në fjalë i gjeti në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil (pika 3 dhe 4, e nenit 67), përsëri arrijmë në konkluzionin se ky punonjës nuk e përfiton statusin e nëpunësit civil.

Në këtë përfundim arrihet për faktin se, çdo punonjësi në këtë kategori, i cili në datën 26.02.2014, që shënon edhe fillimin e efekteve juridike të ligjit, ka qenë në një pozicion pune pjesë e shërbimit civil, i ka lindur e drejta e përfitimit të statusit të nëpunësit civil, nëse ekzistonin kushtet e pikës 3, të këtij neni, që parashikonte kohën që punonjësi kryente funksionet në pozicionin përkatës, si dhe të pikës 1, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit....", i ndryshuar, që ka të bëjë me plotësimin e disa kriterëve specifike, nga ana e kandidatëve për nëpunës civilë.

Në këtë moment, (data 26.02.2014) punonjësi \*\*\*\*\*, ende nuk e përmbushte kriterin e arsimit, të kërkuar për vendin e punës dhe kriterin e vjetërsisë, (pasi, ashtu si e kemi paraqitur më sipër, diploma "Master Shkencor" është lëshuar në datën 30.08.2014) e për këtë arsye, në bazë të nenit 67 të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, dhe pikës 6, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit....", njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit duhet të kishte vendosur përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.

Fakti që aktualisht, ky nëpunës e ka përmbushur kriterin e nivelit arsimor, nuk e ndryshon këtë përfundim, pasi Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, është një institucion që ka qenë i përfshirë edhe më parë në fushën e shërbimit civil dhe nuk është nga ato institucione që janë bërë pjesë e këtij sistemi, për shkak të veprimit të ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar.

Për këtë arsye, punonjësi në fjalë, nuk mund të përfitojë as nga e drejta e parashikuar në pikën 6/1, të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014 të Këshillit të Ministrave "Për statusin e nëpunësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, nëpërmjet së cilës i jepet mundësi punonjësve të institucioneve të varësisë, që hyjnë rishtas në shërbimin civil, nëpërmjet parashikimeve të ligjit në fjalë, të cilët nuk e plotësojnë kriterin e nivelit të diplomës së arsimit të lartë, për pozicionin e punës ku janë emëruar, të

vazhdojnë të punojnë në atë pozicion, me kushtin që brenda një afati 2 vjeçar, të plotësojnë këtë kriter.

Gjatë verifikimit të mënyrës se si është aplikuar në rastin e këtij punonjësi, deklarimi i statusit të punësimit, Komisioneri vlerëson se, nga ana e Departamentit të Administratës Publike, në ushtrim të funksione të veta gjatë këtij procesi, janë lejuar shkelje të procedurave specifike të përcaktuara në këtë rast, në ligj dhe në aktet nënligjore që kanë dalë për zbatimin e këtij instituti të rëndësishëm të ligjit.

Këto shkelje procedurale qëndrojnë, *së pari*, në mos respektimin e afatit ligjor për deklarimin e statusit të punësimit, të përcaktuar në Vendimin nr. 116, datë 05.03.2014, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil, sipas ligjit nr. 152/2013 “Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, sipas të cilit ky afat është 120 ditë kalendarike, nga momenti i fillimit të efekteve juridike të ligjit. Ndërkohë që, Departamenti i Administratës Publike e ka realizuar këtë proces me aktin nr. 1603/1092, datë 08.06.2015, pra rreth 12 muaj me vonesë, duke mos pasur asnjë arsye të përligjur në këtë rast, ç’ka ka mundësuar që të vijojë për një periudhë relativisht të gjatë kohe, një marrëdhënie pune në kundërshtim me ligjin;

Gjithashtu nga ana e Departamentit të Administratës Publike, nuk janë respektuar procedurat specifike të vendosura për të garantuar procesin e verifikimit të statusit të punësimit në këtë rast.

Konkretisht, është lejuar që të deklarohet si nëpunës civil në periudhë prove ky punonjës, në kushtet kur ai nuk i plotësonte kërkesat e posaçme për vendin e punës, sepse në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, ky punonjës nuk plotësonte kriterin arsimor për pozicionin *“Përgjegjës i Sektorit të Projekteve TIK”*, të përcaktuara në Vendimit nr. 1184, datë 20.08.2008, të Këshillit të Ministrave *“Për përcaktimin e procedurave të rekrutimit e të emërimit, të afateve të kalimit nga një nivel më i ulët në një nivel më të lartë karriere dhe për marrjen e masave disiplinore për punonjësit e administratës tatimore Qendrore”*, i ndryshuar ( aneksi 1).

Për të gjitha arsyet e përmendura në pjesën arsyetuese të këtij vendimi, ku Komisioneri ka evidentuar një sërë veprimesh administrative të pa rregullta, nga Departamenti i Personelit në institucionin e DPT, si dhe të Departamentit të Administratës Publike, të kryera gjatë gjithë dinamikës së zhvillimit të kësaj marrëdhënie punësimi, vlerësohet se, akti administrativ i deklarimit të statusit të punësimit, si nëpunës civil në periudhë prove, për punonjësin \*\*\*\*\*, është një akt i pavlefshëm, pasi ka dalë në kundërshtim flagrant me përmbajtjen e ligjit.

Për këtë shkak, duke marrë parasysh rrethanat e konstatuara dhe në vështrim të nenit 67, të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, Departamenti i Administratës Publike, duhet të revokojë aktin e deklarimit të statusit të punësimit dhe të nxjerrë aktin e refuzimit të statusit të nëpunësit civil, pasi në momentin e hyrjes në fuqi të ligjit, nëpunësi \*\*\*\*\* nuk plotësonte kriterin e arsimit të kërkuar për atë pozicion pune, si dhe të përfundojë menjëherë marrëdhënien



e punësimit, me punonjës in në fjalë, për shkak të ligjit dhe të marrë masat për të rregulluar pasojat, duke e shpallur pozicionin e punës si vend të lirë, për t'u plotësuar më tej sipas kërkesave të nenit 22 e vijues të ligjit për nëpunësin civil.

Ndërkohë, nga ana tjetër, ky punonjës, nuk ka asnjë pengesë ligjore për të marrë pjesë në konkurrimin e zhvilluar për këtë pozicion pune, në kushtet kur, aktualisht ai i plotëson kriteret e përgjithshme dhe ato specifike, që parashikohen në përshkrimin e punës.

#### **Për këto arsye:**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, të ndryshuar, si dhe nenin 16 dhe 35, të Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me Vendimin nr. 17, datë 11.03.2013, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

#### **VENDOSA:**

1. Të kërkoj nga Departamenti i Administratës Publike që për rregullimin e gjendjes së ligjshmërisë, të konstatoj si akt absolutisht të pavlefshëm, aktin administrativ nr.1603/1092, datë 08.06.2015, të Departamentit të Administratës Publike, që ka lidhje me deklarin e statusit të punësimit, si nëpunës civil në periudhë prove, të punonjësit \*\*\*\*\* , pasi ka dalë në shkelje flagrante të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”* dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil” i ndryshuar.*
2. Të konstatoj, si akt absolutisht të pavlefshëm, aktin administrativ nr. 13787 prot, datë 23.04.2015, *“Për konfirmimin nëpunës civil pas përfundimit të periudhës së provës”*, i nxjerrë nga eprori direkt, pasi ka dalë mbështetur mbi një akt administrativ absolutisht të pavlefshëm.
3. Departamenti i Administratës Publike, referuar nenit 67, të ligjit nr.152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, dhe të Vendimit nr. 116, datë 05.03.2014, të Këshillit të Ministrave, *“Për statusin e nëpunësve dhe punonjësve aktualë që përfitojnë statusin e nëpunësit civil sipas ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”*, sipas rregullimit të posaçëm ligjor në këto dispozita, duhet të vendosë përfundimin e marrëdhënies së punësimit për këtë punonjës.
4. Njësia përgjegjëse, të marrë masat për të shpallur si të lirë pozicionin e punës, me qëllim që ai të plotësohet në përputhje me kërkesat e nenit 22 e vijues të ligjit nr. 152/2013 *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar.

5. Për kryerjen e këtyre veprimeve administrative, lihet afat 15 ditë nga marrja dajeni për këtë vendim.
6. Me kalimin e këtij afati, institucioni është i detyruar të njoftojë me shkrim Komisionerin për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, në lidhje me zbatimin e këtij vendimi.
7. Të njoftohen për këtë vendim, Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve, Departamenti i Administratës Publike dhe punonjësi \*\*\*\*\*.
8. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**KOMISIONERI**

**Pranvera STRAKOSHA**